



Pranimi / Date e marrëveshjes / Received / Date		23.04.2021	1	viti / god / year
Organ / Organizata / Org / Unit	Nr. Prot. / Prot. No.	Shtojca / Prilog / Appendix		Sasia / Kolicina / Quantity
SRMASHICK	1983/2021			115



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO**

**A.nr.248/2021**

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës** – Kolegji për shqyrtimin e ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Ardita Haxnikaj-Demi dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, sipas Aktgjykimit A.nr.1295/18 të Gjykatës Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative të datës 23.03.2021 ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.299/2019 të datës 28.05.2019 të parashtruar nga ankuesja me adresë banimi: Major Mehmet Bush, L3/9, Komuna e Prishtinës, kundër Vendimit me numër 14-070/01-0065588/19 të datës 20.05.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Komunës së Prishtinës, në çështjen juridike “kompensim material”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 23.04.2021, mori këtë:

**V E N D I M**

**I. REFUZOHET si e pabazuar ankesa** me numër A.nr.299/2019 e datës 28.05.2019, e parashtruar nga ankuesja

**II. SHFUQIZOHET vendimi** me numër 14-070/01-0065588/19 i Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Komunës së Prishtinës i datës 20.05.2019.

**A r s y e t i m**

Ankuesja sipas kontratës së punës të datës 18.12.2012 me numër 01.nr.20-47618/3 dt.18.12.2012 ka qenë në marrëdhënie pune me Komunën e Prishtinës në vendin e punës “Zëvendës drejtoreshë në SHFMU “Nazmi Gafurri”, dhe me datë 02.08.2017 i përfundon marrëdhënia e punës për shkak të arritjes së moshës së pensionimit. Ankuesja me datë 09.10.2017 parashtron ankesën me numër 14-070/01-0251421 në Komision për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Komunës së Prishtinës për mos pagesë me rastin e pensionimit sipas Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive.

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Komunës së Prishtinës, me datë 01.11.2017 nxjerr vendimin numër Nr.14-070/01-0251421/17 duke refuzuar e ankesën e ankueses të datës 09.10.2017.



Ankuesja me datë 02.11.2017 parashtron ankesë me numër të protokollit 4540 në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, i cili komision me datë 18.12.2017 me numër 2-1K/4679 merr vendim me të cilën shpallet jo kompetent për të vendosur për ankesën e ankueses lidhur me mos marrjen e pagave jubilarë pas pensionimit.

Ankuesja me datë 27.12.2017 ka parashtruar padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë kundër organit të punësimit respektivisht Drejtorisë së Arsimit të Komunës së Prishtinës. Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni për Çështje Civile nxjerr Aktvendimin me numër C.nr.3674/2017 të datës 08.03.2017 me të cilin e shpall veten jo kompetent dhe pas që ky vendim merr formën e prerë nxjerr Aktvendimin me numër C.nr.3554/17 të datës 30.04.2018 me të cilin vendos që lëndën në fjalë t'i dorëzojë për shqyrtimin Departamentit për Çështje Administrative të Gjykatën Themelore në Prishtinë.

Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamentit për Çështje Administrative në Prishtinë me datë 02.08.2018 ka nxjerrë Aktvendimin me detyrimin që në afat prej 8 (tetë) ditësh paditësja obligohet të bëjë precizimin padisë me arsyetimin se pala në procedurë administrative mund të hap konflikt vetëm ndaj aktit administrativ të formës së prerë dhe nëse nuk bëhet precizimi i padisë me dëshminë se pala i ka shterur mjetet juridike duke i bashkangjitur vendimin e Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, padia e paditëses hedhet poshtë.

Gjykatë Themelore në Prishtinë-Departamentit për Çështje Administrative nxjerr Aktvendimin me numër A.nr.1111/18 të datës 26.10.2018 me të cilin hedhet poshtë padia e paditëses si e parregullt, pasi që brenda afatit të përcaktuar nuk e ka bërë precizimin e padisë së datës 27.12.2017.

Ankuesja me datë 21.03.2019 me numër 14-070/01-0065588/19 parashtron përsëri ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Komunës së Prishtinës, lidhur me pretendimin ankimor për mos kompensimin e pagave jubilarë. Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Komunës së Prishtinës me datë 20.05.2019 merr vendimin me numër 14-070/01-0065588/19 me të cilin vendim refuzohet si e pa bazuar ankesa e ankueses.

Ankuesja e ka pa kënaqur me vendimin e datës 20.05.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Komunës së Prishtinës, me datë 28.05.2019 parashtron ankesën me numër të protokollit 2497/2019 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 05.06.2019 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit tek Komuna e Prishtinës. Më datë 13.06.2019 Komuna e Prishtinës, ka dërguar përgjigjen në ankesë me provat e bashkangjitura të lëndës 1/8.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nga muaji janar i vitit 2019 deri më datë 08.10.2020 ka qenë jo funksional dhe nuk ka vendosur për ankesën e ankueses, ndërsa më datë 15.07.2019, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka njoftuar ankuesen për arsyet e mos shqyrtimit të ankesës duke udhëzuar që mund të ndiqni procedurat e mëtejme dhe se në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ mund të filloni procedurën gjyqësore pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative më datë 23.03.2021 ka nxjerr Aktgjykim A.nr.1295/18 me të cilin ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit duke anuluar njoftimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të datës 15.07.2019 duke e





detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës që brenda 30 ditësh të vendos për ankesën e ankuesit të datës 228.05.2019.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën e ankueses të datës 28.05.2019 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kontratën e punës e datës 18.12.2012; Vendimin e datës 29.06.2017 për pensionimin e ankueses; Vendimin e datës 01.11.2017 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Komunës së Prishtinës; Vendimin e datës 18.12.2018 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë; Librezën e Punës me numër 120571; Gjendja e llogarisë bankare e ankueses; Vendimi i datës 20.05.2019 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Komunës së Prishtinës; Aktvendimin A.nr.1111/18 i Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative i datës 26.10.2018; Aktvendimin me numër A.nr.1111/2015 i Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative të datës 02.08.2018; Aktvendimi me C.nr.3554/17 i Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti i Përgjithshëm; Aktvendimi me C.nr.3674/2017 i Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative; Thirrjen për shqyrtim kryesor nga Gjykata Themelore në Prishtinë; Procesverbali i datës 07.03.2018 i Gjykatës Themelore në Prishtinë; Aktvendimin me C.nr.3554/17 i Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti i Përgjithshëm; Përgjigja në padi nga Komuna e Prishtinës e datës 29.02.2018; Aktvendimin me C.nr.3554/17 i Gjykatës Themelore Prishtinë/Departamenti i Përgjithshëm; Padinë e ankueses e datës 22.12.2017 për Gjykatën Themelore në Prishtinë; Përgjigjen në ankesë nga organi i punësimit me shkresat e bashkangjitura të lëndës; Ankesën e ankueses e datës 21.03.2019 e parashtruar në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Komunës së Prishtinës; Njoftimi i datës 15.07.2019 i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Aktgjykimin numër A.nr.1295/18 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për çështje Administrative të datës 23.03.2021.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, duke u bazuar kompetencat e tij dhe pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankueses **është e pa bazuar, sepse:**

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, gjatë shqyrtimit dhe analizimit të provave të lëndës të ofruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankuesja pas ankesës së parashtruar në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Prishtinës të datës 09.10.2017 si dhe ankesës së datës 02.11.2017 të parashtruar në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, me datë 27.12.2017 ka ngrit padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative kundër Komunës së Prishtinës, ndërsa Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative më datë 26.10.2018 nxjerr Aktvendimin me numër A.nr.1111/18 me të cilin e hedhë poshtë padinë e paditëses si të parregullt, me këshillën juridike se: *“Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 dite, nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit, përmes kësaj gjykate”* dhe se nga provat e ofruara nga ankuesja me rastin parashtrimi të ankesës së datës 28.05.2019 në Këshill, ankuesja nuk ka sjell asnjë provë që dëshmojnë se ka ushtruar ankesë në Gjykatën e Apelit sipas këshillës juridike, por e njëjta ka zgjedhur që sërish të parashtojë ankesë me datë 21.03.2019 në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Prishtinës.

Po ashtu, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se ankuesja me rastin e parashtrimi për herën e dytë të ankesës së datës 21.03.2019 në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Prishtinës në formularin e plotësuar me përmbajtën e ankesës ka deklaruar se paraprkishtë iu ka drejtuar Gjykatës dhe se të njëjtit e kanë udhëzuar që ajo të bëjë kërkesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil, ndërsa sipas saj Këshilli e ka sugjeruar që paraprkishtë duhet të bërë ankesë në Komisionin e Ankesave, mirëpo për deklarimin e bërë nuk ka



bashkangjitur asnjë provë relevante edhe pse këshilla juridike në aktvendimit me numër A.nr.1111/18 Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamentit për Çështje Administrative të datës 26.10.2018 ka qenë shumë e qartë. Andaj, Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Prishtinës me rastin e trajtimit të ankesës së datës 21.03.2019 për herën e dytë si dhe nxjerrjes së vendimit me numër 14-070/01-0065588/19 të datë 20.05.2019 ka vepruar në kundërshtim me nenin 101 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe 1.2 i Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative i cili ka përcaktuar se: *“Një organ publik përfundon një procedurë administrative, në cilëndo fazë të saj, nëse zbulon se: 1.1. gjatë më pak se dy (2) viteve para datës së parashtrimit të kërkesës, ka vendosur për të njëjtën kërkesë të paraqitur nga pala e njëjtë, me të njëjtin qëllim dhe bazuar mbi të njëjtën situatë faktike”* në kundërshtim më nenin 97 paragrafin 3 të të njëjti ligj i cili përcakton se: *“Një procedurë administrative përfundon, gjithashtu, në praninë e një prej rasteve të parapara në nenet 101 – 104 të këtij Ligji. Në këtë rast përfundimi i procedurës administrative bëhet me një akt administrativ që nuk shprehet mbi thelbin e çështjes administrative”* si dhe në kundërshtim edhe me nenin 52 paragrafi 1 nënparagrafi 1.3 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative i cili përcakton se: *“1.3. është rezultat i shkeljes të dispozitave lidhur me procedurën administrative”*, ngase ankuesja e ka pasur një aktvendimi përfundimtar të shkallës së parë në instanca gjyqësore, respektivisht Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative ka nxjerrë Aktvendimin numër A.nr.1111/18 me datë 26.10.2018 me të cilin e ka hedhur poshtë si të palejuar padinë e ankueses e cila për bazë fillestare ka pasur ankesën e parashtruar në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Komunës së Prishtinës të datës 09.10.2017 me pretendimet ankimore se sipas Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive me rastin e pensionimit i takojnë 3 (tre) paga të rregullta dhe 3 (tre) paga jubilarë, ankesë e cila është refuzuar me rasti e nxjerrjes së vendimit numër Nr.14-070/01-0251421/17 të datës 01.11.2017. Andaj, mbi këtë bazë Kolegji Konstaton se vendimi i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Komunës së Prishtinës i datës 20.05.2019 me numër 14-070/01-0065588/19 është nxjerrë nuk kundërshtim me dispozita e lartcekura ligjore si i tillë nuk prodhon asnjë efekt juridik për palët, ndërsa ankesa e ankueses është e pa bazuar dhe po ashtu, Kolegji konstaton se një akt administrativ i cili sipas dispozitave të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative është përcaktuar se në cilat raste është i paligjshëm dhe nuk prodhon efekte juridike, s’mundet me qenë objekt i shqyrtimit në kuptimin e shterjes së mjeteve nëpër shkallshmëri në një procedurë administrative.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar që Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Komunës së Prishtinës me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër 14-070/01-0065588/19 të datës 20.05.2019, ka vepruar në kundërshtim me dispozitat Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën Administrative, dhe Rregulloren Nr. 05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe të Ankesave, sepse nuk ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga kryetari i kolegjit

**Këshillë juridike:** *Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës  
Lënda me numër A.nr.248/2021

**Flakron Gashi**

*Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional*



Vendimi i dorëzohet:

- *Ankueses*
- *Kryetarit të Komunës së Prishtinës;*
- *Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Prishtinës dhe*
- *Arkivit të KPMSHCK-së.*

